

## 70 MIJË TON GRURË MË SHUMË SE SA E NJEJTA PERIUDHË E VITIT 2009

-Vazhdon shkarkimi i grurit në kalatën 5-

Sot në kalatën 5 të portit detar po shkarkohen 1377 ton grurë nga anija tregtare “Frojdi II”, porosi e grosistëve shqiptarë të miellit. Megjithëse importet në portin e Durrësit kanë pësuar ulje, sasia e grurit të përpunuar është rritur ndjeshëm gjatë javëve të fundit.

Sipas statistikave të Autoritetit portual në periudhën janar-gusht 2010 në portin detar janë shkarkuar 194.848 ton grurë gjithsej.

Vetëm në gusht në port janë shkarkuar mbi 50 mijë ton grurë, ndërsa mesatarja mujore deri në korrik arrinte vetëm në 21 mijë ton.

Shifrat e drithit (grurë rinfuzo) që ka mbërritur me anije gjatë tetë muajve të parë të këtij viti janë 53 përqind më të larta se sa e njejtja periudhë e vitit 2009.

Anijet tregtare me grurë përpunohen kryesisht në kalatën 5 të portit me dy elektrovinxha në dispozicion. Një ditë më parë në të njejtën kalatë përfundoi shkarkimi i grurit nga anija “Izzet Reis”.

